



VENDIM

Nr. 43, Datë 12.04.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SH.A NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “BANJË” ME FUQI TË
INSTALUAR 73 000 KW DHE “MOGLICË” ME FUQI TË INSTALUAR
182 500 KW (ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 255 500 KW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec-et “Banjë” dhe ‘Moglicë’,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘a’, ‘b’, ‘c’, ‘d’, ‘e’, ‘f’, ‘g’) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërma ‘b’, ‘c’ dhe ‘d’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërma ‘a’), do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëhëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për liçensimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Banjë” me fuqi të instaluar 73 000 KW dhe “Moglicë” me fuqi të instaluar 182 500 KW (me fuqi totale të instaluar 255 500 KW).
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 43, Datë 12.04.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SH.A NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “BANJË” ME FUQI TË
INSTALUAR 73 000 KW DHE “MOGLICË” ME FUQI TË INSTALUAR
182 500 KW (ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 255 500 KW)**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____